



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

23.01.2024
Nr. i Protokollit: 92-25

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe në nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, Departamenti i Shpronësimit në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Zyrën për Komunikim me Publikun në Shtime organizon:

D Ĕ G J I M P U B L I K

Lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda juridiksionit territorial të Komunës së Shtimes, më **30 janar 2024** (e martë), në ora **10:30**, në sallën e Kuvendit Komunës së Shtimes, mbahet dëgjimi publik për Zonën Kadastrale në Reçak.


Gjatë këtij dëgjimi publik, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK), do të bëjë prezantimin e projektit: **Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë në Kompleksin Memorial "Masakra e Reçakut"**

Dëgjimi Publik do të udhëhiqet nga Departamenti i Shpronësimit.

Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në tel. 044/201-984 ose përmes postës elektronike: info.shtime@rks-gov.net

Ju mirëpresim!

Shtime, më 23. 1. 2024





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/182
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme e cila preket nga realizimi i Projektit: Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë në Kompleksin Memorial "Masakra e Reçakut" Zona Kadastrale Reçak, Komuna e Shtimes, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronave të shpronësuara dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktūrës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Shpronësimit/Departament za Ekspropriaciju/Department of Expropriation

K.K. SHTIME				Z.K. REÇAK				
Gjendja e vjetër								
Nr.	Komuna	Zona Kadastrale	Pronari	Nr. i ngasirës	Kultura Klasa		Sipërfaqja [m²]	Lloji i ndryshimit koha kur është bërë akti ose dokumenti në të cillin bazohet ndryshimi
1	2	3	4	5	6		7	8
2	Shtim e	Reçak	Faton (Sadik) Osma ni	1086- 3	Pemi shte e Klasë s 3		1005	16.06 .2022

K.K. SHTIME				Z.K. REÇAK				
Gjendja e re								
Nr.	Komuna	Zona Kadastrale	Pronari	Nr. i ngastrës	Kultura Klasa	Sipërfaqja e mbetur [m ²]	Sipërfaqja për Shpronësim m ² -Agjencia për Menagjimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës-AMKMK	Vërejtje
9	10	11	12	13	14	15	16	17
2	Shtime	Reçak	i gjerta rishëm	1086-3	Pemishte e Klasës 3	0		Sipërfaqja e tërësishme për shpronësim, Në parcelën gjendet objekti me Etazhitet P+1 me sipërfaqe: Për rrdhesa 76.45m ² , Kati 1: 79.96m ²
			AMK MK		Pemishte e Klasës 3		1005	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Shpronësimit/Departament za Ekspropriaciju/Department of Expropriation

N J O F T I M

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, dhe pikës Nr.5 të Vendimit të Qeverisë Nr.05/182 datë 10.01.2024 njoftohen të gjithë subjektet në listën bashkëlidhur këtij njoftimi se:

1. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik dhe vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve të nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të Kosovës, mbas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, në zbatim të ligjit të lartpërmendur, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Vendimin **Nr.05/182 datë 10.01.2024** me të cilin aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme e cila preket nga realizimi i Projektit : Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë në Kompleksin Memorial "Masakra e Reçakut" ZK Reçak, Komuna e Shtimes, sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Qeveria do të marrë një Vendim Preliminar mbi Ligjshmërinë e Shpronësimit të Propozuar, brenda 30-ditëve kalendarike, mbas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, lidhur me organizimin e dëgjimit/ve publike.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin Shpronësues-Departamenti i Shpronësimit, brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së Vendimit të Qeverisë **Nr.05/182 datë 10.01.2024** për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim, në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
4. Qeveria do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e propozuar në Komunën ku gjenden pronat, përkatësisht për Zonën Kadastrale Reçak, Komuna Shtime.
5. Të gjithë personat të cilët janë zyrtarë publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronarë ose zotërues të interesit në pronën e cila gjendet brenda kësaj Komune ose avokat apo përfaqësues të ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.

6. Çdo person i lartpërmendur do t'i jepet mundësi e arsyeshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2 deri 4 të nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010.
7. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete prova të arsyeshme (*dokumente*) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotëruesi të Interesit.
8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda juridiksionit territorial të **Komunës së Shtimes** do të mbahet me datë **30 Janar 2024, Ora 10:30 në Sallën e Kuvendit Komunal të Shtimes, përkatësisht për zonën kadastrale:**

Reçak

9. Në rast se prona e cila është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të iniciuar në përputhje me atë kërkesë, asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmirësimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbylljes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010.
10. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtojë Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e të drejtave të tyre sipas ligjit.
11. Çdo Person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilëndo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëherë duhet të dërgojë në Organin Shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfarëdo dokumenteve që ndërlidhen me atë pretendim.